

## KERKESE PER KONSULTIM ME PUBLIKUN

Drejtuar: AKM-se Tirane

Per dijeni: DRM-se Fier




*Instalimi – Industrite energjetike*

*Industrite energjetike, ID 1.10 "Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.*

Vendodhja: Lagjia "24 Maji", rruga Sazani, prane ish uzinies SODE-PVC.

Zhvilluesi:

Shoqeria "Begaj-Lepenica" sh.p.k



Mars 2022



**Hyrje**

Kerkesa per pjesmarrjen ne organizimin e konsultimit me publikun dhe palet e interesuara hartohet per aplikim per leje mjdisi tipi B, **Industrite energjetike, ID. 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.**, bazuar kjo ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ky aktivitet zhvillohet nga shoqeria "Begaj-Lepenica", sh.p.k i regjistruar ne QKB, me numer NUIS K86723210B me fushe veprimtarie "Tregtim me pakice te karburanteve".

Vendodhja e karburantit eshte lagjien "24 Maji" ne rrugen Sazani, prane ish uzinies SODE-PVC. Trualli me siperfaqe totale 2600 m<sup>2</sup> dhe siperfaqe ndertimi 625m<sup>2</sup>, eshte ne process legalizimi. Z. Bege Begaj administrator i shoqerise, ka dorezuar fomularin e Vetedeklarimit per legalizimin e objektit prane Njesise se Urbanistikes se Njesise se Urbanistikes se Njesise se Qeverisjes Vendore, Bashkia Vlore.

Koordinatat e objektit jane:

Nr	X	Y
1	4369387.19	4483135.68
2	4369390.19	4483146.60
3	4369384.47	4483161.48
4	4369390.82	4483165.05
5	4369388.40	4483174.46
6	4369406.03	4483185.60
7	4369398.76	4483198.71
8	4369378.24	4483189.57
9	4369359.15	4483198.33
10	4369336.43	4483207.61





# Objekti "Begaj-Lepenica"

<https://geoportal.asig.gov.al>  
Data e Printimit: 09.06.2021.

453965.868  
4482090.535

454136.549  
4482090.535



453965.868  
4481981.966

454136.549  
4481981.966

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.  
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

## KUADRI LIGJOR

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligji Nr. 52/2020, per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 12/2015 date 26.2.2015 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date 7.7.2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Menaxhimin e integruar te burimeve ujore "

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"

Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

### Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime

VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore"

VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.

VKM Nr.686, date 29.7.2015 per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.



Udhezim i Ministrisë së Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrisë së Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrisë së Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore. Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit."

Udhezim i Ministrisë së Mjedisit Nr.1, date 07.01.2008 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrisë së Mjedisit, Nr.429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

Gjate vitit 2011, jane miratuar edhe tre ligje te rendesishme per mjedisin:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit Europian dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"

Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktiven 85/337/KEE te Keshillit, date 27 Qershor 1985 "Mbi vleresimin e efekteve te projekteve publike dhe private ne mjedis", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10448, date 17.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktivat:

2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar te ndotjes", e ndryshuar

Direktiven 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 23 Tetorit 2001 "Mbi kufizimin e shkarkimeve te disa ndotesve ne ajer nga instalimet e medha me djegie"

Te tre keto ligje nuk kane hyre ende ne fuqi pasi eshte duke u pergatitur aktet e nevojshme nenligjore. Keto tre ligje hyjne ne fuqi ne Shkurt te vitit 2013

## **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

Aktiviteti "Magazinin dhe tregtim i naftes dhe benzines" i subjektit "Begaj-Lepenica" sh.p.k. me administrator znj. Avni Begaj qe ndodhet ne rrugen Sazani, eshte e pajisur me Leje Mjedisore me PN-7792-08-2014 Nr. i identifikimit te lejes 7 nga Agjensia Rajonale e Mjedisit Vlore.



Foto 1-Karburanti „Begaj-Lepenica“

Pika e shitjes me pakice te karburanteve, sic u tha edhe me siper, ndodhet ne rrugen Sazani , duke plotesuar te gjitha kerkesat, perfshire dhe ato urbanistike per nje destinacion te tille, ndikon ne gjallerimin e infrastruktures perkatese ne sherbim te vete shoqerise.

Karburanti eshte projektuar ne baze te kushteve teknike dhe normave te projektimit per impjantet dhe instalimet, qe sherbejne transportin, depozitim dhe tregtimin e naftes dhe neproduktet e saj dhe konkretisht nga pjesa e trete qe permban kushtet teknike dhe normat e projektimit te stacioneve te shitjes se karburanteve per furnizimin e automjeteve. Gjithashtu jane pasur parasysh dhe udhezimet perkatese te I.Q.T.

Konkretisht i eshte kushtuar vemendje:

- Zona dhe rruget e kalimit
- Vendosja e stacionit te karburantit
- Klasifikimi i karburanteve qe perdoren
- Zonat e vemendjes
- Bazamentet e pompave
- Ndertesa e stacionit te karburantit
- Kushtet teknike per elementet e stacionit te karburantit
- Rezervuaret nentokesore
- Aksesoret kryesor te rezervuarit
- Pompat e karburanteve
- Tubacionet e stacioneve te karburanteve
- Rregullat e furnizimit te automjeteve
- Rregullat e shkarkimit te karburanteve
- Distancat e sigurise se brendshme
- Distancat e sigurise se jashteme



Duke zbatuar problemet e sipermendura eshte hartuar projekti i stacionit te furnizimit te automjeteve me karburant.

### Rezervuaret e karburanteve

- ✓ Rezervuaret jane ndertuar prej lllamarine celiku, cilindrike me fund ovale.
- ✓ Gjate ndertimit te tyre jane zbatuar te gjitha rregullat e I.Q.T (I.P.N.P)
- ✓ Per diametrat deri ne 2000mm, trashesia minimale e lllamarines 6mm.
- ✓ Rezervuaret jane pajisur me bakaporte me te dhena teknike dhe numrin e fabrikimit
- ✓ Lidhjet teknologjike dalin nga bakaporta ose trupi vetem me filanxha
- ✓ Rezervuaret paisen me sistem tokezimi dhe mbrojtje katodike
- ✓ Rezervuaret jane lyer me boje anti-korodive dhe hidrolizohen me kujdes te vecant
- ✓ Tubacionet behen celik inoxdabel, ose xingato te kualitetit te larte
- ✓ Tapat e hermetizimit behen alumin, bronx me fileto te imet konike
- ✓ Cdo rezervuar eshte ndare me parete te holla betoni
- ✓ Ne dysheme eshte bere sistemi i filterimit te ujrave nentokesore
- ✓ Lartesia e pusetes se betonit ne siperfaqen e objektit per bakaportat 500mm
- ✓ Rezervuaret jane vendosur ne dy mbeshtetese betoni me lartesi 300mm, te llogaritura per te mbajtur ngarkesen.

### Ne rezervuar jane vendosur:

- ✓ Valvola kendore moskthimi per thithje
- ✓ Kapake hermetizues per nivelin dhe sistemimin e mbushjes (alumin, bronx)
- ✓ Sistemi i ajrimit eshte pajisur me shuares flake, valvol moskthimi
- ✓ Guarnicionet jane te pershtatshem per karburante
- ✓ Tubacionet dhe armaturat jane prej materialesh te pa ndryshkeshem

Kapaciteti depozitues i kesaj pike eshte: 50 000 Iitra karburant te lenget te ndara ne tre depozita. Kjo sasi eshte shperndare ne 2 nenprodukte te naftes dhe benzines. Ne skeme jane vendosur dy distributore per dy produkte me kater pistoleta. Rezervuaret jane prodhime vendi, me forme cilindrike dhe te vendosur horizontalisht. Distributoret jane prodhime importi.

### **Produktet (lenda e pare qe magazinohet) qe tregtohen jane:**

- Naft
- Benzin

### **Karakteristikat e lendes se pare qe shiten jane:**

#### **Karakteristikat e naftes**

- Densiteti ne 20 °C 0.837 gr / cm<sup>3</sup>
- Densiteti ne 15 °C 0.848 gr / cm<sup>3</sup>

- Fillimi i vlimit 175 °C
- Vlone deri ne 250 °C , perqindja e vol – 46 %
- Vlone deri ne 350 °C , perqindja e vol – 96 %
- Vlone deri ne 370 °C , perqindja e vol – 50 %
- Aciditeti total 0.02 mgr KOH / gr
- Viskoziteti kinematik ne 400 °C 2.2 est
- Koksi Conradson ( 10 % te mbetjes se distilantit 0.02 )
- Permbajtja e hirit 0.02 % / m
- Permbajtja e sqfurit 0.02 % / m
- Temperatura e flakerimit 157 0 C
- Permbajtje e ujit : nuk ka
- Mbeturina mekanike : nuk ka
- Korozioni ne baker ( 3 ore ne 50 °C ) reziston
- Temperatura e ngrirjes – 10 °C

#### **Karakteristikat e benzines**

- Densiteti ne 20 °C 0.723 gr / cm<sup>3</sup>
- Numri i oktanit , metoda motorike -54
- Fillimi i vlimit ne temperaturen eshte ne 69 °C
- 10 % distilohen ne temperaturen 86 °C
- 50 % distilon ne 113 °C
- 90 % distilon ne 148 °C
- Mbarimi i vlimit ne temperaturen 170 °C
- Mbetjet pas distilimit 1.5 %
- Humbje + mbetje 3.5 %
- Permbajtja e sqfurit 30 ppm
- Permbajtja e plumbit 1.9 ppb
- Prova e pllakes se bakrit reziston
- Aciditeti organik ne mg kohe / 100 ml benzine 0.7
- Acide dhe baza te tretura ne uje neutrale
- Reshirat faktike ne mg / 100 ml benzine -
- Papasteri mekanike + uje -
- Numri i bromit G. Brom / 100 g benzine 1.2

#### **Lendet ndihmese jane:**

- ✓ Energji elektrike
- ✓ Uje





Foto 2 Ambjentet e karburantit



Foto 3 Distributorët e karburantit




Foto 4 Depozitat e karburantit



Foto 5 Kabina e rojes



# PIKE SHITJE KARBURANTI



## **MBROJTJA NDAJ ZJARRIT**

### **SISTEMI I H/Z**

Ky sistem eshte llogaritur me shuarje me uje dhe shkume dhe pluhur,mbasi eshte sistemi me i pershtatshem per shuarjen e zjarreve te "klases B & C" (kryesishte materiale te gazta dhe te lengeshme te djegeshme).

Ne llogaritjen dhe dimensionimin e H/Z jane marre ne konsiderat normat e rekomanduara UNI 10 779, ne funksion te nivelit te rrezikut te zones qe mbrohet.

Eshte perzgjedhur niveli I dyte (klasa B, sipas UNI 9489), me ngarkese zjarri te larte. me sasi uji min. 180 l/minut dhe me kohezgjatje minim.30 minuta.

Uji do te sigurohet nga ujesjellsit te Qytetit ose pus par per te patur nje garanci ne perballimin dhe funksionimin e sistemit eshte planifikuar nje rezerve uji 5000 lit dhe nje rezerve shkume e barabarte me S50 lit.

Ky sistemshperndares me H/Z eshte i tipit te hapur me magjistral dhe tuba zingato 2 1/2", e mbrojtur nga ngrirja dhe goditjet, ku eshte vendosur nje hydrant mbi toke me nje dalje, DN 50(2") me kasete te jashtme me kollone, si dhe nje hydrant HZ.(me nje dalje)qe do te sherbeje per lidhjen e tubacionit te zjarrfikses me reduktor presioni sic tregohet ne vizatim.

Gjithashtu eshte parashikuar nje system dushimi me sprinkera per ftohjen normalizimin e temperatures se cisternes se gasit, si dhe nje mbulesa e lehte per te mos lejuare depertimin e rrezeve te djellit.

### **Grupi i pompave**

Llogaritja e sasise se ujit te nevojshem ne rast zjarri eshte kalkuluar duke konsideruar rrezikshmerine e cfaqjes se tij ne nivelin e dyte (ngarkese zjarri e larte) si dhe duke ju referuar tipit te objektit (B), pike ka buranti. Ne baze te ketyre te dhenave percaktojme elementet baze hidraulik H/Z sikurse prurja, presioni, njekohshmeria, zgjatja e erogacionit minimal etj.

Sikurse e kemi permendur me siper eshte perzgjedhur sistemi me nje kollone per te perballuar nje prurje  $Q = 180$  l/min ,nje presion 3 bar- me nje zgjatje te prurjes prej jo me te madhe se 30 min. Pra ne 1 ore duhet te sigurojme nje prurje prej  $Q = 10$  m<sup>3</sup>/h. Per realizimin e kesaj perzgjidhet grupi i pompimit se bashku me aksesoret e nevojshem.

Pompa duhet te jete mire pozicionuar sidomos perpara dhe anash per te siguruar nje hapsire te dobishme per kryerjen e sherbimeve dhe operacioneve te mirmbajtjes. Per te evituar rezonancat dhe tensionet mekanike nga lineariteti jo i mire ne montim, duhen parashikuar si ne kolektorin e thithjes dhe ne ate te dergimit xhunto elastike. Rekomandohet qe te instalohen suportte mbeshtetes ne tubot anesore te kolektoreve te dergimit dhe te thithjes. Pompa munde te hyje ne pune ose te ndalet ne menyre automatike ose manuale, ne menyren automatike, duhet te llogaritet koha e nderhyrjes, jo me e madhe se 30 minuta , e barabarte me sasine ujit te rezervuare.

Pompa furnizohet me energji elektrike nga rrjeti i vacant dhe ne rast nderprerje te energjise do te furnizohet nga gjenerator ose burim tjeter energjie.



**Pjesa hidraulike - Perberja**

Nje pompe me dy xhirante me aks vertikal

Bazament me celik zingato I kompletuar me kembeza game kunder vibrimit

Kolektor me fllanxa prej celiku zingato ON 32

Komponente hidraulike si valvola mas kthimi ne aspiracion per cdo pompe si dhe saracineska me sfera ne aspiracion dhe dergim.

Elemente kontrolli dhe sigurie si manometer (0- 10) bar serbator me membrane.

Centraline per prove javore e perbere nga oroloxhio javore, elektrovalvola shkarkimi, alarm zanor dhe pamor si dhe buton te emergjences me aktivizim me dare.

Per shuarjen e zjarrit jane parashikuar te vendosen 4 fikse me pluhur 12 kg dhe 1 fikse me plur 6 kg per ambientet e sherbimit, sic eshte percaktuar ne vizatim.

Gjithashtu do te vendoset 2 fikse te levishme me karrele, 50 kg me pluhur, dhe nje 50lt. me shkume.


Paisjet dhe materjalet e perdorura ne objekt duhet te jene cilesore konforem standarteve shteterore si dhe normat dhe standartet teknike nderkombtare te pranuar, CEN; DIN; etj.

Eshte vendosur dhe sinjalistika (tabela) paralajmeruese dhe emergjente, rregullorja e brendeshme etj.

Ne rast zjarri apo emergjence tjeter, personeli duhet te zbatohen detyrat sipas rregullores dhe procedurave te paracaktuare, dhe te njoftohen menjehere organet kompetente dhe te specializuara ne numrat e telefon pa pagese: ZJARRFIKESJA - 128; POLICIA- 129; URGJENCA- 127.

MBROJTJA NGA ZJARRI

PLANIMETRA E PIKES SE KARBURANTIT



LEGIENDA SIMBOLE

	HIZ 1 1/2" me tub naltori 20 m
	Linje e ujit zjarifikes 2"
	Fikses me pluhur 6 kg
	Fikses me pluhur 12 kg
	Hidrant mbi toke me dy dalje
	Fikses me pluhur 30 kg
	Rrezik nryme elektrike
	Ndalohet perdorni i ujit per shuarjen e zjarrit ne pajise elektrike
	Kaseta e ndihmes se shpese

VLORE

ZVERNEC

**OBJEKTI:** PIKE KARBURANT

**PAZA:** Ekipi M.K.Z

**PROJEKTI:** SHKURIM I PIKES SE KARBURANTIT

**SHKILLA:** 1:100

**PLANIMETRA:** PIKE SE KARBURANTIT

**FLETAN:**

NUMRA TE EMERGJENCES

POLICIA	129
URGJENCA	127
ZJARRFIKESJA	123


LEGIENDA

1	Rezervuar karburanti 50000 lit
2	Tabella
3	Rezervuar uji 5000 litra
4	E/pompa zjarifikese
5	Distributor gazi



PLANIMETRA E PIKES SE KARBURANTIT  
RRJETI I FURNIZIMIT ME UJE TE HIDRANTEVE

MBROJTJA NGA ZJARRI



**LEGJENDA SIMBOLE**

	HIZ 1 1/2" me tub nalloni 20 ml
	Linje e ujit zjarifikues 2"
	Fiksë me pluhur 6 kg
	Fiksë me pluhur 12 kg
	Hidrant mbi tokë me dy dalje
	Fiksë me pluhur 30 kg
	Rrezik rryme elektrike
	Ndaloher personim i ujit për shkak të rrezikut të zjarrit me pajisje elektrike
	Kasida e ndihmës së shpejtë

**OBJEKTI: PIKE KARBURANT**

**VLORE**

EMPL. MUKZ  
INVESTORI: "BAG" ZKORR

PLANIMETRIA PËR SHITJE KARBURANTI

PLANIMETRIA



**NUMRA TE EMERGJENCES**

POLICIA	129
URJENCA	127
ZJARRFIKESJA	128


**LEGJENDA**

1	Rezervuar karburanti 5000 lit
2	Tabela
3	Rezervuar uji 5000 litra
4	E/pompa zjarifikese
5	Distributor gazit



Skema tip e instalimit te autoclaves - Pompa e jashtme



Hidrant i tipi 1 (mbullore)



Hidrant i tipi 2 (pombe)





## PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI

- **Shtrirja gjeografike**

Aktiviteti i tregtimit të karburantit ndodhet në lagjen "24 Maji" në rrugën Sazani, në afërsi të ish-Uzines SOD-PVC. Në afërsi të objektit ndodhet impinati i trajtimit të ujërave të ndotura të qytetit të Vlores. Zona ku ndodhet objekti karakterizohet si një nga zonat periferike të qytetit të Vlores pranë Pyllit të Sodes i cili është çilesuar si mushkri e qytetit.

- **Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues**

Biodiversiteti-Bashkia e Vlores përfshin zona të rëndësishme natyrore siç është ajo e Nartes, e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit, të cilat për vetë llojshmerinë, veçantinë e llojeve që ato strehojnë dhe sasine të tyre të konsiderueshme, e bëjnë hapësirën e kësaj bashkie të një rëndësie të vecantë kombëtare dhe nderkombëtare. Sistemi ligatinor Narte-Vjose me VKM

Nr.680, datë 22.10.2004 është shpallur peizazh ujor/tokesor i mbrojtur, ndërsa ishulli I Sazanit përfaqëson një pjesë të Parkut Kombëtar tokë/det. Këtu dallohet sigurisht laguna, kodrat e mbjella me ullinj dhe vreshta, dallohet bimesia tipike mesdhetare, pyjet me pisha, rezervuarët me ujë të embel për ujë, dunat, fushat dhe lëndinat. Sigurisht që kjo zonë mbart një numër të madh habitatesh natyrore të rëndësishme në nivel kombëtar dhe nderkombëtar.

Kjo pasuri natyrore përben një tërheqje turistike që do të ushtrojë një presion mbi të si pasojë e zhvillimit të saj.

Në habitatet detare dhe bregdetare, në stadin mediolitoral, janë të pranishme, si në ishullin e Sazanit edhe në gadishullin e Karaburunit, biocenozat e dominuara nga *Lithophyllum byssoides*. Kjo algë e kuqe kalcike, lloj karakteristik i Mesdheut perëndimor dhe

detit Adriatik, rritet pak mbi nivelin e detit, në zgavra të vogla, korridore dhe përgjate faqëve shkembore. Në këto zone ajo formon jastek të vegjël (masa gjysem sferike) dhe rralle formon breza, zakonisht të njohur si "trotuar". Një tjetër biocenoze e mediolitoralit është ajo e shpellave të mediolitoralit, të cilat janë të çara apo hyrje të shpellave që janë pjesërisht jashtë

ujit. Biocenoze tjetër e rëndësishme është ajo e shpellave gjysem të errëta, ku jeton koral i kuq (*Coralium rubrum*) dhe disa lloje sfungjesh. Biocenoza e Koralligjenit gjendet në substratet e forta, me algë të kuqe të kalcifikuara, gorgonie dhe brizoare. Kjo biocenoze është e zhvilluar me të mirë në anën perëndimore të ishullit të Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit.

Në ujërat e zonës Karaburun-Sazani është raportuar prania e breshkave të detit, delfineve, dhe fokës së Mesdheut, të cilat janë ndër llojet më të kercënuara në shkallë globale.

Raporte të ndryshme shkencore theksojnë se përgjate bregut perëndimor të gadishullit të Karaburunit gjenden habitate mjaft të pershtatshme për fokën e Mesdheut.

Kjo zonë është edhe një korridor i rëndësishëm për migrimin e breshkave të detit nga zonat e tyre të folezimit në ishujt Grekë në detin Jon për në bregdetin e Patokut në pjesën shqiptare të detit Adriatik, e cila së fundmi është identifikuar si një zonë e rëndësishme ushqimi për këto lloje breshke.



Brigjet e Gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit karakterizohen nga një shumëllojshmeri peisazesh me shkëmbinj të pjerret e të pakalueshem, me shpella, hone, kepe, plazhe të vogla e gjire. Keto formacione terheqese behen edhe me interesante për syrin e vizitorit fale bimesise se zhvilluar mire, e cila mbylun pothuajë të gjithë gadishullin që nga maja e malit e deri në breg.

Vlerat mjedisore, natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike, biodiversiteti dhe larmia e peisazheve e bëjnë këto zone një nga pikat me terheqese persa i takon turizmit.

Topografia interesante nenujore, me shpella e mikro habitate shume të larmishem, si dhe prania e anijeve të mbytura, i japin zonës me tepër vlera turistike, veçanërisht për të apasionuarit pas sportit të zhytjes.

Larmia e madhe e formacioneve topografike me shkëmbinj të thepisur dhe të pakalueshem, kanione, shtigje e fushëgropa ofron mundësi të mira që përveç sporteve të ujit të zhvillohen edhe alpinizmi, shetitjet me kuaj apo sporteve të tjera.

Aneksi i kufizuar në zonën e Sazani-Karaburunit, kryesisht si pasoje e mungesës së rrugëve dhe bregut të thepisur shkëmbor, ka mbrojtur dhe ruajtur habitatet natyrore. Sidoqoftë, ekzistojnë mundësi për një akses të kontrolluar të turistëve dhe vizitorëve në zone nepermjet shtigjeve që kalojnë nga zonat pyjore e kodrinore dhe/ose me varka në plazhet dhe gjirët e vegjel, ku ka mundësi ancorimi, si gjiri i Raguzës dhe gjiri i Shen Janit në bregun lindor, dhe gjiri Bristanit, gjiri i Dafines dhe gjiri i Gramës në bregun perëndimor të Karaburunit.

Studimet e shumta në zonën e Nartës e kanë renditur atë si zonën e dytë me të rëndësishme për shpendet e ujit në Shqipëri (Karavasta është zona me të rëndësishme) ku gjatë periudhës së dimrit strehohen një numër i madh i tyre. (me shume se 23% e shpendeve të ujit).

Për flamingot *Phoenicopterus ruber roseus*, rosen laramane *Tadorna tadorna*, rosen bishtgjele. *Anas acuta*, rosen me kater sy *Bucephala clangula*, vraponjesin gushebardhe *Charadrius alexandrinus* dhe gjelzen pikaloshe *Pluvialis squatarola*, Narta përben vendin me të rëndësishëm të dimerimit në Shqipëri. Vlen të përmendet edhe prania e pelikanit kacurrel

*Pelecanus crispus* (9%) dhe pulebardhes së Audouinit *Larus audouinii* (100%), lloje këta të konsideruar si "Globalisht të Rrezikuara".

Ekosistemi natyror i Nartës shihet si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore të Evropës dhe si një kompleks i rëndësishëm ndërkombëtar. Për tri lloje, Narta kap me shume se 1% të popullatës rajonale. Një e treta e llojeve (11 lloje) që i takon listës së "Gjitareve Globalisht të Kercënuara" (IUCN, 1996), tregojnë për rëndësinë jo vetëm kombëtare të zonës, por edhe për atë ndërkombëtare. (Medetcoast Raporti i Nartës, 2004).

Kjo zonë shpesh për shkak të larmisë që ofron ka qenë dhe është një zonë objekt-studimi për mjaft kërkues, studiues, institucione shkencore dhe mesimore etj. Kjo tregon për rëndësinë e lartë në nivel lokal por edhe në nivel kombëtar si dhe për disa elemente të saj edhe në nivel ndërkombëtar.

Të gjitha këto lloje përbejnë një pasuri pasi një pjesë e tyre përdoren për qëllime mjekësore, industrinë ushqimore dhe si bime dekorative. Një pjesë e tyre janë të rralla dhe rrezikohen të



zhduken. Zona ne studim permban rreth 1400 lloje bimesh enezore qe perfaqesojne rreth 42% te teresise se bimeve ne Shqiperi.

Habitatet me te rendesishme te saj mund t'i permbledhim sipas karakteristikave ne:

Habitatet ujore qe perbehen nga ana e tyre ne subhabitate si ai i kenetes se perhershme, kenetes se perkohshme, kenetat me uje te kripur, kanalet e ujitjes dhe te kullimit, rezervuaret e ujit te embel; pyjet aluvionale dhe pyjet e pishes; kodrat e ullinjve dhe vreshtave; dunat ranore; shtrati i lumenjve, toka dhe deti.

Ne kenetat e perkohshme qe dallohen nga levizjet e nivelit te kripesise qe eshte me I larte ne sezonin e thate dhe me e ulet ne ate te lagesht. Ne kete habitat mbizoterojne lloje si *Ranunculus* spp, *Callitriche truncata*, *Chara* spp., *Tolypella* spp., *Chara canescens*, *Chara galioides*, *Ruppia maritima*, *Zannichellia pedunculata*, *Suaeda maritima* dhe *Suaeda splendens*. Nuk mungojne dhe disa zona kullotjeje ku zhvillohen *Scirpus* spp. Qe zevendesohen vende-vende nga *Phragmites communis*.

Kenetat e perhershme ne zone jane laguna e Nartes, Kallenges dhe e Orikumit ku gjenden *Zostera noltii* dhe *Ruppia cirrhosa* si dhe disa lloje algash jane llojet qe kryesisht gjenden ne fundin e tyre dhe perbejne biocenozen.

Ne kete habitat perfshihen kenetat ekripura si ajo e Nartes me nje bimesi tipike qe perballon kripesine e larte si *Salicornia* spp., *Arthrocnemum* spp., *Salsola soda*, *Limonium* spp por edhe lloje si *Arthrocnemum fruticosum*, *A. perenne*, *A. glaucum*, *salicornia europea*, *Salsola soda*, *Juncus acutus*, *Juncus maritimus*, *Inula crithmoides*, *Limonium vulgare*, *Artemisia coerulescens*, *Halimione portucaloides* etj kur niveli i kripesise bie.

Ne grupin e habitateve te kanaleve te kullimit dhe ujitjes si dhe ato te rezervuareve te ujit te embel gjenden tipe halo-higrofile si *Phragmites australis*, *Typha angustifolia*, *Typha latifolia*, *Scirpus lacustris*, *Scirpus maritimus*, etj, po ashtu jane dhe algat notuese si *Lemna minor*, *Lemna minuta*, *Spyrodela polyrhiza* etj. Habitatet e tyre jane te rendesishme pasi perbejne te vetmin burim uji te embel ne zone.

Fauna-Pervec bimesise te permendur me siper ne kete zone dhe qe jane te lidhura me te gjendet nje faune e pasur rreth 747 lloje vertebrore, si peshq, shpend, amfibe, reptile, gjitare, molusqe, insekte, ekinodermate etj. Nder invertebroret dallojme rreth 390 lloje molusqe, flutura, krustace dhe ekinodermate. Peshqit me te njohur ne kete zone jane ato te detit dhe te ujit te embel ku dallojne Ngjala (*Anguilla anguilla*), Koca (*Sparus aurata*), Levreku (*Dicentrarchus labrax*), Qefulli (*Mugil cephalus*), si dhe *Aterina* sp, *Solea vulgaris*, *Liza aurata*, *Trachurus trachurus*, *Mullus barbatus* etj.

Nga shpendet ku dallohen ato te llojit dimerues dhe folezues dhe jane ne total rreth 192 lloje mund te permendim Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), Capka e madhe e bardhe (*Egretta gazeta*), Rosat e ndryshme (*Anas* sp.), Lejleku (*Ciconia ciconia*), Kredharaket e ndryshem (*Podiceps* sp.), Skifteret e ndryshem (*Falco* sp), Shqiponja (*Halieetus albicilla*), Thelleza e fushes (*Perdix perdix*), Laraska e



detit (*Haematopus ostralegus*), Pulebardhat e ndryshme (*Larus sp.*), Dallendyshet, Bilbilin, Laureshat, Korbin, Sorrat, Mellenja (*Turdus merula*), Harabelat (*Passer*), etj.

Amfibet po ashtu jane te shumte ne numer dhe mund te permendim *Triturus sp.*, *Bufo sp.*, *Rana sp.* Ne total ka 9 lloje, ndersa nga reptilet *Caretta caretta*, *Coluber sp.*, *Lacerta sp.*, *Testudo hermani*, *Vipera ammodytes*, *Elaphe sp.*, etj ne total 26 lloje.

Gjitaret ne kete zone jane te shumte ne numer rreth 32 lloje ku mbizoterojne brejtesit dhe lakuriqet e nates, por mund te permendim edhe gjitaret e rendit te *Insectivora*, *Chiroptera*, *Carnivora*, *Cetacea* etj.

Flora-Ishulli i Sazanit, i cili nuk eshte i banuar, eshte pjese e Parkut Kombetar detar dhe tokesor sebashku me Karaburunin dhe jane kategoria e dyte e zonave te mbrojtura. Ishulli I Sazanit eshte 4,8 km i gjate dhe 2 km i gjere me nje siperfaqe prej afro 5,7 km<sup>2</sup>. Ai eshte i perbere nga shkembinj gelqerore te periudhes se Kretakut dhe ne anen lindore te tij me depozitime terrigjene. Klima e Sazanit eshte e bute, mesdhetare. Temperatura mesatare vjetore eshte 16,2 grade Celsius. Mesatarja e janarit eshte 10°C dhe e korrikut 23,4°C. Sasia mesatare e reshjeve eshte 715 mm ne vit. Ai karakterizohet nga nje biodiversitet i larmisem. Ne shpatet kodrinore te ishullit ne lartesi te ndryshme jane te mbuluara nga shkurre te dendura te dominuara nga *Quercus coccifera* si dhe *Murtus comminis*, *Fraxinus ornus* etj. Ne pjesen e brendshme te tij gjendet nje brez vegjetacioni me ekspozim nga deti ne lartesi 50-100 m i dominuar nga *Euphorbia dendroides*, *Pistacia lentiscus* etj. Ne kete bimesi gjenden edhe lloje te kercenuara si *Athamanta macedonia*, *Brassica oleracea*, *Capparis spicosa* etj. Habitatet bregdetare dhe detare te ishullit dallohen ne pjesen shkembore te bregut.

Brigje me rere jane te ngushta dhe te pakta. Brezi me i ulet i habitateve bregdetare deri ne lartesine 5-6 m dominohet nga komuniteti ksero-halofitik *Crimtho-Limonietaea*, ndersa brezi i siperm dominohet nga aleanca *Capparo-Putorion* Lov.

Kati Medioloral me dy biocenoza karakteristike: Biocenoza e shkembinjve te medioloralit te poshtem me lloje karakteristike te Mesdheur perendimor si *Lithophyllum byssoides*, e cila eshte nje alge e kuqe qe krijon pamjen e nje "trotuari" ne breg. Gjithashtu ketu dallojme edhe biocenozen e shpellave te medioloralit. Kati Infralitoral karakterizohet nga livadhet me *Posidonia oceanica*. Prania e tyre deshmon per pastertine e ujit te detit ne kete gji.

Gjithashtu pjese e ketij kati jane edhe Biocenzat e algave te murme, e koraligjenit, qe ka nje substrat te forte me alga te kuqe te calcifikuara si gorgonie dhe briozoare. Kjo biocenoze eshte e zhvilluar me mire ne pjesen perendimore te ishullit. Ketu gjendet edhe alga *Corallium rubrum*, qe eshte lloj i perfshire ne Aneks II te Konventes se Barcelones, shfrytezimi i se ciles eshte i kontrolluar. Se fundi, mund te permendim makrofaunen bentike te zones se Sazanit ku gjenden grupe te rendesishem te molusqeve, krustaceve dhe ekinodermate.

### Pyjet dhe Natyra



**Natyra.** Shqipëria jugperendimore është një zonë e tradita vetë qendrueshme, mjedis natyror me një bukuri të madhedhëje historike të gjatë që daton që nga kohët parahistorike, e cila është edukuese për mes mbetjeve arkeologjike dhe monumenteve të epokave ndryshme. Nder burimet e konsiderueshme natyrore të vendosura brenda Bashkisë së Vlores do të përmendim, Gjirin e Vlores, lagunen e Nartes, Zverneci, lagunen e Orikut si dhe Parkun Kombëtar Karaburun-Sazani.

**Gadishulli i Karaburunit**-konsiderohet si një krah shkëmbor i gjatë 16 km dhe i gjërë 4 km. Brigjet veriore dhe perendimore janë rreth 14 km të gjata e shkojnë nga Kepi i Karlovecit deri në Kepin e Gjuhezes (përfshirë një bazë ushtarake të braktisur) e me pas nga veri – veriperendim drejt jug – juglindjes tek kepi i Bristanit, ku ndodhet një bazë ushtarake aktive.

Shpatet e anës perendimore janë vende – vende shumë të thepisura. Bregu perendimor i Karaburunit, shënuar nga kanione të thella (përrenj sezonal) që rrallë mbarojnë me xhepa plazhesh ranore apo me guraleca, karakterizohet nga faqe shkëmbore vertikale e të larta që shkojnë deri në thellesi të mëdha nën ujë. Keta shkëmbinj janë mjaft të eroduar dhe në të mund të shihen një numër shpellash (shumica nën ujë) ku shpesh rrjedhin burime me ujë të freskët.

**Ishulli i Sazanit**- ka një formë elipsoide me drejtim veri – veriperendim – jug – juglindje, me gjatësi rreth 4.8 km, gjëresi maksimale 2 km, dhe një sipërfaqe totale prej 5.7 km<sup>2</sup>. Pjesa perendimore karakterizohet nga shkëmbinj që ngrihen vertikalisht mbi det të ndërprerë nga kanione të thella që zgjerohen nga shpellat, kryesisht në ujë, ashtu siç vërehen dhe në Karaburun. Në anën lindore, bregu është me ujë dhe në pjesën jugperendimore formohet nga shtresa shkëmbinjsh gelqeror të pjerret që zhyten në det.

Në këtë zonë gjendet edhe laguna interesante e Orikut, e vendosur në brendësi të një zone të ndaluar ushtarake. Ajo zë një sipërfaqe prej 130 ha, ka një thellesi maksimale prej 3 km dhe është në komunikim të vazhdueshëm me detin nëpërmjet një kanali 50 m të gjatë.

**Laguna e Nartes**-me sipërfaqe 45 km<sup>2</sup> është liqeni i dytë detar për nga madhësia në Shqipëri. Veçori e saj është numri i madh i shpendeve dhe peshqve që jetojnë në të.

Prej disa shekujsh këtu jetojnë edhe një koloni pelikanësh. Edhe sot në këtë lagunë ruhet tradita e peshkimit me varka druri. Në kodrat përreth peshkatartë nartiotë kanë treguar se janë kultivues të famshëm edhe të vreshtarise, e cila prodhon verë dhe njohur të Nartes.

**Zverneci** është një nga zonat turistike të Vlores. Këtu ndodhet Triporti një bukuri natyrore e paeksploruar nga vizitorët. Në vitet 1970 arkeologu Vasil Bereti kreu këtu disa fushata gërmimesh, ku dolën në dritë porti detar, disa mure rrethuese, disa ndërtesa, karkasën e një anijeje dhe qeramika të ndryshme.

**Gjiri i Vlores** është gjiri më i madh i bregdetit shqiptar, që nis që nga Kepi i Pllakes në Trepot dhe vazhdon drejt jugut, duke krijuar formën e një krahu të hapur deri në Gjirin e Shen Janit në veri të Karaburunit. Në hyrje të tij gjendet ishulli i Sazanit me një largësi prej 17 km nga qyteti i Vlores.



Gjiri i Vlores ka nje gjatesi prej 19 km, gjeresi prej 9.5 km dhe thellesi 54 m. Pjesa perendimore e tij qe shtrihet pergjate gadishullit te Karaburunit perbehet nga nje bregdet shkembor ndersa pjesa lindore perbehet nga nje bregdet i ulet ranor, i pasur me disa plazhe.

Ujerat e Adriatikut qe perbejne kete gji arrijne temperatura qe variojne nga 13°C ne stinen e ftohte te dimrit e deri ne 25°C ne muajt e nxehte te veres, te cilat mundesojne banjat detare dhe peshkimin pothuajse gjate gjith vitit. Relievi perreth i mbart te gjitha format, duke nisur nga kurrizi i kodrave te Treportit, pasqyra e Lagunes se Nartes, Kodrat e Zvernecit, gropa e Vlores, kodrat rreth saj, kalaja e Kanines, mali i Shashices, mali i Lungares, Llogoraja, per te vazhduar me tej me Rrezen e Kanalit, luginen e Dukatit, Karaburunin duke e mbyllur unazen ne Sazani, piken me perendimore te Shqiperise.

**Laguna e Orikumit** dallohet per shpendet dhe speciet e shumta te liqeneve detare, ku nga veprimtarite ekonomike mund te veqojme peshkimin.

**Mjedisi Natyrore** – Mjedi natyror i Bashkise Vlore eshte pjese e nje zone me te gjere peizazhi bregdetar, i cili formon nje vazhdimes imjedisore. Plani i Menaxhimit te Integruar te Bregdetit (1995), identifikon pese fusha ekologjiksht te ndjeshme, domethene zonat me bukuri natyrore, vlera historike dhe kulturore dhe biodiversitet te pasur: Gadishulli i Karaburunit; Kanioni i Vunoit; Porto Palermo; Plazhi I Kakomes; Butrinti. Gadishulli i Karaburunit ndodhet brenda Bashkise se Vlores, ndersa te tjeret jane gjithashtu ne afersi. Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit, e cila eshte miratuar nga Qeveria Shqiptare ne vitin 1999 identifikon zonat ekologjiksht te ndjeshme. Kjo liste perfshine te gjitha fushat e permendura me lart, me perjashtim te Kanionit te Vunoit.

- Llogara- Orikum, Karaburun- Sazani- Radhime- Tragjas- Dukat (Vlora)
- Kanioni i Gjipese (Vlora)
- Porto Palermo (Vlora)
- Perroi i Borshit (Sarande)
- Plazhi i Kakomes dhe Kepi i Qefalis (Sarande)
- Kanali i Cukes – plazhi i Ksamilit dhe ishujt (Sarande)
- Liqeni i Butrintit dhe rrethinat (Sarande dhe Delvine)
- Pagane- Kepi i Stillos dhe ishujt (Sarande)

**Parku Kombetar Detar Karaburun – Sazani.** Me propozim te Ministrise se Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, me date 28 tetor 2010, Keshilli i Ministrave me vendimin Nr. 289, shpalli zonen Karaburun – Sazani si te paren zone te mbrojtur detare (Park Detar) ne Shqiperi.

Bazuar ne te dhenat ekzistuese, zona e Ishullit te Sazanit dhe pjesa perendimore e Gadishullit te Karaburunit eshte dalluar nga zonat e tjera te ngjashme, duke u shpallur si Zona e Pare e Mbrojtur Detare ne Shqiperi (ZMD). Pjesa bregdetare e Ishullit te Sazanit dhe pjesa perendimore e Gadishullit te Karaburunit mendohet te perfshihet gjithashtu ne zonen e mbrojtur detare per shkak te vlerave te larta te biodiversitetit dhe habitateve te rendesishme natyrore.

Ne zonen Sazani – Karaburun gjenden te pakten 36 lloje me interes nderkombetar te perfshira ne listat e llojeve te rezikuara dhe/apo te mbrojtura te disa konventave. Ketu perfshihen bari i detit,



sfungjeret, knidaret, molusqet, krustacet, ekinodermatet, peshqit, zvarraniket, fokat dhe cetacete. Ne zonen Sazani – Karaburun jane regjistruar rreth 75% e llojeve te rrezikuara te kafsheve detare ne shkalle kombetare, shumica makro – invertebrore te bentosit, te cilat jane perfshire ne Librin e Kuq te Faunes se Shqiperise (2006) dhe ne listen e Kuqe te Faunes Shqiptare (2007).

Pyjet e Valanidhit ne Gadishullin e Karaburunit konsiderohen si pyjet me te ruajtura ne Shqiperi. Shpatet kodrinore dhe habitatet e tjera te Gadishullit dhe ishullit karakterizohen nga nje diversitet i larte i tipeve te vegjetacionit.

Pyjet- zene nje perqindje relativisht te vogel te territorit te bashkise. Ka dy lloje tokash pyjore. Shumica e tokes pyjore eshte e pozicionuar ne pjesen malore te Llogarase dhe Shushices. Pylli me pisha i Llogarase i pozicionuar ne pjesen e brendshme jugore eshte nje nga peizazhet me karakteristike natyrore malore ne mbare vendin. Gjithashtu, pjesa e pyllit te Shushice me pemet e lisit kontribuon ne atraktivitetin e bregdetit te Jonit ne Vlores. Ne pjeset kodrinore ne veri dhe ne lindje te qytetit te Vlores pemet e lisit jane zevendesuar me ullinj. Disa kane mbetur vetem disa segmente te vogla.

Nje lloj i dyte i pyllit me pisha vihet re ne token e sheshte pergjate bregdetit Adritatik (Pylli i Sodes), i cili vazhdon pergjate bregdetit Adriatik ne perendim te lagunes deri ne grykederdhjen e lumit Vjosa. Nje segment i vogel toke pyjore mbetet ne ishullin e Sazanit.

Pyjet aluvionale jane nje tjeter habitat i rendesishem qe karakterizohet nga dy kate bimesie, kati i pare nga ai i kallamishteve qe perfaqesohet nga klasa Phragmitetalia, si dhe shoqerohet nga *Typha angustifolia*, *Lythrum salicaria*, *Polygonum hydropiper*, *Polygonum lapathifolium*, *Sium latifolium*, *Gratiola officinalis*, *Cladium mariscus*, *Alisma plantagoaquatica*, *Sparganium erectum* etj dhe qe gjenden kryesisht ne dy anet e kanaleve ujiteshe dhe lumenjve, ndersa kati i dyte nga bimet e bregut te lumit si p.sh ato te klases Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea. Gjithashtu ne disa vende gjenden shelgjet si *Salix elaeagnos*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, etj.

Pyjet halore jane nje habitat masiv ne zone te cilat mbulojne rreth 1,200 ha, i cili eshte krijuar nga njeriu rreth 40 vite me pare nga mbjellja qe eshte bere me qellim zvogelimi e fenomenit te erozionit duke stabilizuar vijen bregdetare. Llojet dominuese jane pishat si Pine sp. si p.sh *Pinus maritima*, *P. pinea* dhe *P. Pinaster*, si dhe nga shkurret mesdhetare me nje lartesi jo me te madhe 2m si *Pistacia lentiscus*, *Erica manipuliflora*, *Myrtus communis* etj.

Prane plazhit te Zvernecit gjendet edhe nje brez me *Agave americana*.

Dunat ranore perbejne nje tjeter habitat te rendesishem ku dunat ranore arrijne deri ne disa metra lartesi dhe ku bimesia mundon ne rreth 30 metrat e para, ne vazhdim gjenden lloje te Phanerogameve sikurse edhe *Cakile maritima*, *Xanthium strumarium* subsp. *italicum*, *Salsola kali*, lloji karakteristik i dunave si *Ammophila arenaria* subsp *arundinaceae*, etj.

Ishulli i Zvernecit paraqet nje zone te nje rendesie te vecante si dhe nje habitat te pasur me pyje (rreth 7 ha) te Selvise (*Cupressus sempervirens*) qe mbulojne rreth 80-90% i shoqeruar me *Quercus ilex*, *Quercus pubescens* dhe *Pinus spp.*, me nje lartesi rreth 8-10 m. Gjithashtu ne kete ishull gjendet edhe nje shtrese me shkurre si *Myrtus communis*, *Pistacia lentiscus*, *Laurus nobilis*, *Rubus spp.*,



Phillyrea angustifolia, Olea olaster, etj, dhe se fundi nje shtrese bimesh barishtore e rralle me lloje si Chrysopogon gryllus, Asparagus acutifolius, Dactylis glomerata, Desmazieria rigida etc.

- **Klima, hidrologjia dhe infrastruktura ekzistuese**

#### - Klima

Klima- kjo zone ka nje larmi mikroklimash. Klima e bute perben nje nga perpaesite me te medha te saj, pasi eshte e lidhur ngushtesisht me karakterin agro-turistik te zones duke mundesuar shtrirjen ne kohe te kesaj industrie te rendesishme per ekonomine e zones. Temperaturat. Bashkia e Vlores shtrihet ne zonen e ultesires bregdetare me karakteristikat e klimes Qendrore Mesdhetare ku dimri eshte ne pjesen me te madhe te tij I bute, me nje temperature minimale ne muajin Janar (4,8 °C), ndersa vera e nxehte, e thate me nje temperature maksimale ne muajt Korrik dhe Gusht (30 °C).

Tabela 1 Temperaturat ne Bashkine Vlore (°C)

Temperaturat ne Bashkine Vlore (°C)		
Maksimale	Minimale	Mesatare vjetore
30	4,8	15,4-16,3

Vlerat e lageshtise dhe rrezatimit diellor ne Vlore			
Karakteristika	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera mesatare/ Totali
Lageshtia (%)	62	69	66
Rrezatimi diellor (kEh/m <sup>2</sup> )	52.1	216.5	1540

Nga grafiku i mesiperm duket qarte se pjesa e thate e vitit perkon me periudhen qershor- gusht ndersa periudha me e lagesht korrespondon me stinen e vjeshtes dhe ate te dimrit me nje maksimum ne muajin e nentorit. Keto karakteristika te rreshjeve e kategorizojne bashkine e Vlores si nje bashki me tipare te theksuara mesdhetare kryesore te vitit siç jane Janari dhe Qershori. Nga ky trendafil kuptohet se gjate periudhes se dimrit, sidomos ne muajin Janar ererat fryjne kryesisht ne drejtim te Lindjes dhe Veri-Lindjes (L-VL) me nje shpejtesi mesatare prej 3,5 m/s dhe gjate veres ne drejtimin Veri-Perendimor dhe Perendimor (VP-P) me nje shpejtesi mesatare rreth 4,8 m/s. Ererat perendimore karakterizohen nga briza bregdetare ne stinen e veres.

Sipas Institutit Meterologjik Shqiptar ne Bashkine Vlore sasia vjetore e oreve me erera varion sipas zonave nga nje vlere minimale prej 1000 oresh deri ne nje vlere maksimale prej 4500 oresh. Kjo sasi ererash ne zonat me mesatare me te larte mund te shfrytezohet per ta shnderruar energjine mekanike te eres ne disa forma te tjera te energjise dhe qe mund te shfrytezohet per prodhimin e energjise elektrike, per mullinj etj. Kjo energji e rinovueshme dhe e paster do te kursente sasi te medha te emetimit te CO<sub>2</sub> ne atmosfere dhe do te zevendesonte rolin e

nje pylli apo nje siperfaqeje ekuivalente te gjelber. Zonat me 4500 ore/vit mund te konsiderohen si zona te grades se 1 deri 3.

### Ajri

Cilesia dhe Pastertia e Ajrit sot jane nder faktoret kryesore te shtimit te nje numri te madh semundjesh te renda ne popul;late. Ne Bashkine Vlore mund te thuhet se cilesia e ajrit eshte relativisht e kenaqshme. Bazuar ne raportin mjedisor te vitit 2014 ne qytetin e Vlores, ku edhe parametrat mjedisor jane me te kercenuar se sa ne zonat e tjera te bashkise, rezultojne ne nivele brenda normes se BE dhe asaj kombetare pothuaj per te gjithë elementet ndotes te ajrit. Keshtu grimcat PM10 dhe PM2.5 rezultojne brenda normes BE prej ( $40\mu\text{g}/\text{m}^3$  dhe  $25\mu\text{g}/\text{m}^3$ )dhe nuk ka as edhe nje dite tejkalim te kesaj norme.

Perqendrimet ditore te  $\text{SO}_2$ , pergjegjes per shirat acide, jane perseri nen vleren norme ditore te BE prej  $125\mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe nuk ka patur tejkalime as orare dhe as ditore. Po ashtu nivelet e  $\text{NO}_2$  jane nen vleren  $40\mu\text{g}/\text{m}^3$  te BE. Situata te ngjashme paraqesin edhe gazet si  $\text{O}_3$ , CO, benzenet etj. Bazuar nga vlerat e marra ne vite per qytetin e Vlores trendi paraqitet dukshem ne renie. Kjo vjen nga mungesa e nje industrie te mirefillte, nga mosfeksionimi i TEC-it, nga mungesa e nje trafiku rrugor te renduar (me perjashtim te sezonit te veres) si dhe nga nje intensitet me i ulet ndertimesh ne zone ne vitet e fundit. Pjesa tjeter e territorit te bashkise nuk paraqet ndonje problematike te veçante lidhur me ndotjen e ajrit.

Perqendrimet ditore te  $\text{SO}_2$ , pergjegjes per shirat acide, jane perseri nen vleren norme ditore te BE prej  $125\mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe nuk ka patur tejkalime as orare dhe as ditore. Po ashtu nivelet e  $\text{NO}_2$  jane nen vleren  $40\mu\text{g}/\text{m}^3$  te BE. Situata te ngjashme paraqesin edhe gazet si  $\text{O}_3$ , CO, benzenet etj. Bazuar nga vlerat e marra ne vite per qytetin e Vlores trendi paraqitet dukshem ne renie. Kjo vjen nga mungesa e nje industrie te mirefillte, nga mosfeksionimi i TEC-it, nga mungesa e nje trafiku rrugor te renduar (me perjashtim te sezonit te veres) si dhe nga nje intensitet me i ulet ndertimesh ne zone ne vitet e fundit. Pjesa tjeter e territorit te bashkise nuk paraqet ndonje problematike te veçante lidhur me ndotjen e ajrit.

### - Hidrologjia

**Sistemi i Ujerave** ne Bashkine Vlore eshte formuar nga nje kombinim elementesh ujerash tokesor dhe bregdetar. Ne lidhje me ujerat bregdetar, aspekti me i rendesishem eshte laguna e Nartes e cila ze nje siperfaqe prej  $2.900\text{ km}^2$  dhe prania e saj dominon pjesen veriperendimore te territorit te bashkise. Kjo siperfaqe e madhe uji ka ndikuar ne jeten e banoreve te fshatrave lokal te Nartes, Panajase, Zvernecit dhe Novoseles te cilet bashkejetojne dhe zhvillojne aktivitete tradicionale ekonomike, te tilla si peshkimi dhe bujqesia, ne harmoni me funksionet ekologjike te zones per disa qindra vjet duke formuar identitetin e tyre te veçante perreth lagunes. Laguna paresore kufizohet nga trupa te tjere me te vegjel uJOR. Nje tjeter zone bregdetare ligatinore me e vogel (Pashai i Limanit) eshte formuar ne jug ne gjirin e Orikumit, ne afersi te skajit te gadishullit te Karaburunit. Lidhur me



ujerat tokesore duhet te theksohet rendesia e Vjoses, lumit me te rendesishem te Shqiperise me nje gjatesi prej disa qindra km qe rrjedh nga rajoni grek i Epirit, duke kaluar nga lugina e Permetit dhe duke arritur detin ne very te lagunes se Nartes. Kjo perben edhe kufirin verior te Bashkise se re te Vlores. Prania e lumit ka nje ndikim te forte ne peizazhin bregdetar. Lumi gjarperon neper nje lugine te hapur per disa km para se te mberrije ne det, ku formohet nje delte e gjere me kon aluvial. Lumi i dyte me i rendesishem i njesise administrative eshte ai i Shushices i cili lidhet me sistemin e Vjoses. Ai rrjedh nga jugu ne drejtim te veriut pas kodrave te Vlores, duke formuar kufirin lindor te njesise dhe derdhet ne Vjose. Burimi i Shushices eshte i vendosur ne pjesen e pasme te maleve te Himares dhe lugina e tij formon nje lidhje te brendshme te natyrshme midis Vlores dhe Vranishtit. Nje sistem i trete lumi eshte ai i Dukatit qe rrjedh neper luginen e Orikumit duke mbledhur ujin nga pjeset malore te lugines.

Pjese te medha te territorit te bashkise pershkohen nga rrjedhat me drejtim nga lindjeperendimi, disa prej te cilave te çojne drejt lagunes dhe detit dhe disa ne brendesi ne drejtim te lumenjve. Per me teper bashkia ka disa rezervuare te ujit, kryesisht ne pjesen verilindore qe perdoren per vaditje, disa prej te cilave paraqesin edhe aspekte argetuese (si Babica e Vogel).

**Ujerat Nentokesore.** Bashkia Vlore ka nje numer te madh ujerash nentokesore me nje rendesi si natyrore ashtu edhe ekonomike. Ato perfshihen ne basenin e ujerave nentokesore kuaternare te Vjoses me nje koeficient shfrytezimi qe varion nga 0.5-0.7; temperatura nga 14-18.7°C; pH varion nga 7.00-8.25. Ato jane burime karstike qe gjenden pergjate zones bregdetare, dhe ne brendesi te territorit te kesaj bashkie. Burimet e ketyre ujerave dalin ne dy nivele; niveli i pare eshte ai afer zonave te banuara dhe niveli i dyte perfaqesohet nga burimet nendetare. Burimet buzedetare dhe nendetare jane nje lloj i veçante i burime karstike. Ne zonen e Narte-Vjoses keto ujera gjenden ne thellesi te cekta kryesisht ne thellesi nga 1m deri ne 10 m. Ne pjesen tjeter te Bashkise (Xyherine, Panaja, etj) ujerat nentokesore gjenden edhe me thelle dhe jane burimi kryesor i ujit te pijshem per pjesen me te madhe te fshatrave, pasi uji i rrjetit eshte mjaft i ndotur si pasoje e amortizimit shumevjeçar te tij dhe si pasoje e mungeses se investimeve te rehabilitimit. Ne Novosele fortesia e ketyre ujerave rezulton Fp nga 15.01-15.43°gj; ndersa permbajtja ne Ca rezulton e larte ne vlera nga 52.14-97.08mg/l. Tendenca e rrjedhjes se ketyre ujerave eshte drejt perendimit ne detin Adriatik. Mungesa e kanalizimeve te ujerave urbane dhe e mos trajtimit te tyre paraparak perben nje rrezik te madh per cilesine e ketyre ujerave dhe perdorimin e tyre per uje te pijshem. Ne pergjithesi rreziku i ndotjes percaktohet si mesatar.

- **Tokat, kategoria e tokes dhe gjeologjia**

Vija bregdetare shquhet per larmi formash e procesesh morfologjike e morfogjenetike (bregdet deltaik e lagunor). Nder elementet kryesor morfo-litologjik vlejne te permenden plazhet ranore, dunat lagunat dhe tokat e lageta bregdetare, thyerje shkembore dhe gjire te vegjel zallor. Ajo ka nje evolucion te shpejte dhe si e tille eshte e ndjeshme, madje reagon, ndaj nderhyrjeve te njeriut.

Vija bregdetare ndahet ne dy tipe kryesore morfologjike:

- Bregdet i ulet, ranor kryesisht akumulues qe shtrihet ne pjesen veriore
- Bregdet i larte, shkembor qe shtrihet ne pjesen jugore dhe perendimore te gjirit te Vlores.



Ketu ruhen gjurmet e tre niveleve te tarracave detare, te cilat perkojne si ne moshe dhe ne lartesine absolute me ato te bregut tjetër te Adriatikut me lartesine 2-8m, 15-20m, 36-40m.

Ne zonen ranore thellesia 20 m eshte 4600m ne drejtim te detit.

Ne veri te Gjirit te Vlores derdhet lumi Vjosa i cili buron ne Greqi dhe pershkon gjithe zonen jugore te Shqiperise dhe derdhet ne veri te lagunes se Nartes.

Per shkak te rrymave detare, llumrat e sjella nga ky lume depozitohen ne pjesen veriore te Gjirit te Vlores. Keshtu perberja mineralogjike e sedimenteve te kesaj zone, ndikohet nga karakteristikat gjeologjike te materialit te sjelle nga lumi Vjosa.

Vija bregdetare e gjirit te Vlores deri ne derdhjen e lumit Vjosa konsiderohet e perbere nga depozitime te vazhdueshme.

Raporti i prurjes se ujit te lumenjve me prurjet e ngurta sedimentare detare eshte 2.5:1. vlere qe tregon se eshte ne favor veprimi akumulues.

Spektori nga Treporti e deri ne Uje te Ftohte eshte ne gjendje ekuilibri te perkohshem. Jetegjatesia e ekuilibrit varet nga kombinimi i faktoreve natyrore me ato humane.

Ne grupin e pare futen kushtet hidrodinamike, sedimentologjike, natyra dhe karakteri i materialit perberes etj. Ne bregdetin e Vlores verehet tendenca e pakesimit te reses per shkaqe te ndryshme si natyrore dhe nga nderhyrja e njeriut (kohet e fundit eshte shtuar ndjeshem nderhyrja e njeriut ). Ne baze te te dhenave, gjate 7-8 vitet e fundit deti ka perparuar rreth 30-40 m.

- **Zonat e Mbrojtura**

Zonat e mbrojtura ne afresi te objektit jane:

**Zverneci**

Ndodhet ne pjesen veri-lindore te Vlores. Monumentet e mbrojtura te ndertuar brenda ketij ishulli jane Manastiri i Zvernecit dhe Kisha e Manastirit, te cilat mbartin vlere te medha historike, kulturore. Pervec monumenteve, Zverneci eshte shpallur ne teresi si nje zone e mbrojtur, ku spikat natyra e gjelber, ndertimet ne brendesi, si dhe qasja e ketij ishulli me ujit.

**Manastiri i Zvernecit**

Ne Zvernec ndodhet Manastiri ne te cilin mund te gjejme gjithashtu Kishen e Shen Merise monument kulture bizantin e shek. XIV. Kjo kisha ndodhet ne ishullin piktoresk te Zvernecit ne lagunen e Nartes. Kjo kisha i takon shekullit te 31-te. Eshte e tipit kryq me kupole e nartes. Ne ambientet e brendshme te saj ruhen fragmente te pikturës murale e altari i gdhendur ne dru zburuar me motive me lule e kafshe. Vlere origjinale kishes i jep edhe hajati i shtruare me plake guri e qe ne anen veriore merr drite nga shtate harqe te mbeshtetura ne kollona guri. Kisha eshte e restauruar dhe eshte monument kulture. Kisha e Shen Merise sherben si vend lutjeje, behen ceremoni fetare ortodokse si dhe çdo vit kujtohet 15 gushti, ditelindja e Shen Merise.

**Kisha e Manastirit te Zvernecit**

Kisha eshte e tipit: kryq i lire me kupole, me narteks dhe ekzonarteks e nje hajat te hapur me kolonade ne anen veriore. Pjesa e vjeter perbehet nga naosi ne forme kryqi te lire me narteks, ndersa pjesa tjetër eshte shtuar me vone. Narteksi eshte drejtkendesh ne plan, me brinje me te gjate nga veri-jug dhe me dritare te vogel ne murin jugor. Ai ka ne anen perendimore porten e mbuluar me arkitrare te rrafshet dhe dy dritare anash. Naosi ka planimetri ne formen e kryqit me krahet lindore



dhe perendimore me te gjate se ata veriore dhe jugore. Objekti ka konstruksion me mure mbajtes. Muri eshte ndertuar me gure zakonshem duke patur edhe copa tullash. Si lidhes eshte llaci I gelqeres. Kultura e perdorur ne kete konstruksion eshte e tipit bizantin ne te cilin jane perdorur dhe kolona cilindrike guri ne arkaden e hajatit. Mbulesa eshte me cati me tjegull vendi.

### **Peisazhi i mbrojtur "Vjose-Narte"**

Objekti I zhvillimit te tregtimit te kaburantit ndodhet ne nje distance rreth 2 km nga Zona e Peisazhit te Mbrojtur (ZPM) Vjose-Narte.

Zona e Peisazhit te Mbrojtur (ZPM) Vjose-Narte (Kategoria e IVIUCN) eshte nje kompleks ligatinor qe shtrihet ne Rajonin e Vlores. Vete zona mbulon nje siperfaqe prej 19738 hektarësh. Lartesia e kompleksit varion nga 0-246 m mbi nivelin e detit. Pika me e larte ndodhet midis fshatrave Hoshtime dhe Llakatund. Potencialet qe e bejne Vjose-Narten per t'u shpallur Peisazhi i Mbrojtur ne Shqiperi jane:

- Vjose-Narta eshte nje zone me rendesi nderkombetare. Peisazhi i Mbrojtur Vjose – Narte perfshihet ne rrjetet ekologjike: Zone kandidat Emerald nen Konventen e Bernes si "Peisazhi i Mbrojtur i kompleksit ligatinor Vjose - Narte" (ID AL0000008, siperfaqe: 19.412,00 hektare, "Peisazhi i Mbrojtur i sistemit ligatinor Vjose-Narte "). Per me teper, siti njihet si Zone e Rendesishme per Shpendet e quajtur "Laguna e Nartes" me ID "AL005" pasi ploteson kriteret A1, A4i, A4iii, B1. Ajo njihet si Zona Kryesore e Biodiversitetit (KBA) ne nivel global e emeruar "Vjose - Narta (Vjose-Pishe Poro-Laguna e Nartes)" me ID ALB24. Zona permbush kriteret Ramsar per numrin e pergjithshme te shpendeve te ujit dimerues me me shume se 34 000 individe (Kriteri Ramsar eshte 20 000 individe). Per tre lloje, zona strehon me shume se 1% te popullates rajonale. Keto te dhena jane te mjaftueshme per ta listuar Vjose-Narten si nje nga zonat me te rendesishme per shpendet ne Shqiperi dhe Rajonin Mesdhetar Lindor. 92 lloje i perkasin grupit te llojeve te vyera.
- Narta eshte ligatina e dyte me e madhe ne Shqiperi. Ajo mban nje numer te madh llojesh, veçanerisht shpend dimerues. Laguna e Nartes eshte zona e dyte me e rendesishme dimeruese dhe folezuese per shpendet e ujit ne Shqiperi.
- Vjose-Narta strehon 26 lloje Globalisht te Rrezikuara dhe eshte keshtu nje zone ruajtja e se ciles ka nje interes mbare boteror. Pervec kesaj, kompleksi regjistron 189 lloje te Rrezikuara ne Shqiperi, fakt qe e rendit ate ne nje zone te vyer e cila meriton te ruhet me kujdes. Rendesia e zones tregohet gjithashtu nga prania e 118 llojeve te mbrojtura ne shkalle kombetare dhe nderkombetare.
- Kompleksi Vjose-Narte eshte nje zone e mirenjohur per floren e veçante dhe larmine e habitateve. Te gjitha keto lloje perbejne nje tipar te rendesishem kombetar me vlera te veçanta ekonomike dhe shkencore. Disa lloje jane shume te rralla per Shqiperine, te tjere kane vlera te rendesishme shkencore, dhe nje numer i larte llojesh perdoren gjeresisht ne ekonomi si bime mjeksore, aromatike, industriale dhe dekorative. Ne peisazhin e mbrojtur Vjose-Narte jane evidentuar 114 bime aromatike mjekesore.
- Zona dallon per vlerat e saj ekologjike, historike, dhe arkeologjike, larmine e habitateve dhe mozaikun e pejsazheve. Llojet me vlere dhe habitatet e bejne ate shume terheqese per edukim



dhe ndergjegjesim publik te nxenesve te shkolles, studenteve, publikut ne pergjithesi dhe madje edhe vendim-marresve. 3

- Prania e pese Monumenteve Natyrore, Manastiri i Zvernecit (nje nga zonat me te vizituara, nje atraksion shume terheqes per qytetin e Vlores) dhe zones arkeologjike te Treportit i japin te gjitha zones vlera te tjera shtese ne aspektin kulturor dhe eko-turistik, duke e bere ate te rendesishme ne shkalle lokale dhe kombetare.
- Zona Vjose-Narte ka qene dhe ende eshte nje qender kerkimi per shume institucione shkencore dhe edukative te tilla si Universiteti i Vlores, Universiteti i Tiranes, Instituti i Hidraulikes, Instituti i Hidrologjise dhe Meteorologjisee, Instituti i Kerkimeve Biologjike, Instituti i Tokave etj. Fushat shkencore te mbuluara nga keto institucione perfshijne hidrauliken, hidrologjine, gjeomorfologjine, socio-ekonomine dhe biologjine (zologjine dhe botaniken)
- Kjo zone gersheton nje larmi kushtesh te pershtatshme per zhvillimin e turizmit si klime te shendetshme dhe kushte sociale e ekonomike te favorshme. Zona eshte e famshme per pasurite e saj natyrore dhe kulturore te cilat mund te mbeshtesin aktivtete eko-turistike te shumta te tilla si shetitje (Kallenga dhe Rezervati i Menaxhuar i Pise-Poros), vrojtime shpendesh ne lagunet e Nartes dhe ne Kriporet, turizem kulturor ne zonat historike te Zvernecit dhe te Treportit

Kufijte e ZPM jane si me poshte:

- Ne Veri – Lumi Vjosa deri ne fshatin Mifol,
- Ne Lindje – Vija qe lidh majat e kodrinave “Mishikarta”, “Cecai”, “Ciplaku”, “Kisha”, “Mutreva” dhe “Babica e Vogel”,
- Ne Jug – Vija qe lidh fshatin e Nartes me fshatin e Zvernecit (Pusi i Mezinit – Fusha e KriporesPylli i Sodes),
- Ne Perendim – Deti Adriatik (Vjose -Treporti). PM shtrihet ne territorin e dy Njesive Administrative: Njesia Administrative Novosele ne veri te saj dhe Njesia Administrative Qender ne jug dhe 18 fshatra (Zvernec, Narte, Panaja, Oshtime, Kerkove, Bestrove, Aliban, Poro, Novosele, Mifol, Cerkovine, Skrofotine, Fitore, Trevllazer, Akerni, Bishan, Delisuf, Dellinje) me nje popullsi prej 24 000 banoresh. Qyteti me i afert eshte Vlora, nje prej qyteteve me te medha te Shqiperise me nje popullsi prej 106 000 banore. Ne zonen e Pise-Poros (Vlore) veqohen depozitimet e neogenit dhe te kuaternarit. Depozitimet e kuaternarit sipas gjenezes se tyre ndahen ne deluvjale dhe aluviale. Depozitimet aluvjale te kuaternarit mbushin gjithe luginen e Vjoses. Perfaqesohen kryesisht nga subargjilat ngjyre kafe te hapet me perberje 5-15 % rere te imet. Ne thellesi argjilat gradualisht ndryshojne ngjyren ne blu te erret dhe permbajne mbeturina organike, fakt ky qe tregon karakterin lagunor te depozitimeve te mevonshme te kuaternarit. Zona e Pise-Poros (Vlore) i perket rajonit te Ultesires aluvionale bregdetare, i cili perfshin zonen bregdetare dhe ultesirat e deltave te derdhjes se lumenjeve me zona me origjine aluvionale dhe detare.



## **VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

Ndikimet negative ne mjedis nga aktiviteti qe ushtrohet vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular kerkese per leje mjedisi tipi B. Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me aktivitetin e tregtimit se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

- **Shkarkimet ne uje**

Gjate zhvillimit te aktivitetit te magazinimit dhe tregtimit te naftes dhe nenprodukteve te saj, nuk kemi shkarkime te ujrave te gjeneruara ne ujrat siperfaqesor. Ujrat qe gjenerohen nga ambientet higjeno-sanitar grumbullohen ne gropen septike te ndertuar nga shoqeria sipas kushteve teknike. Gropa septike pastrohet periodikisht nga kompanit e licencuara per trejtimin e ujit te ndotur.

Ujrat e pastrimit te ambjenteve te aktivitetit dhe te shiut grumbullohen nepermjet sistemit te kunetave te mbuluara me zgate metalike dhe prej andej shkarkohen ne kanalin kullues te ujrave te bardha te zones. Ne afersi te objektit ndodhet dhe hidrovori I qytetit te Vlores. Keto ujra nuk kane prani te karburantit pasi subjekti eshte shume i kujdesshem ne magazinimin dhe tregtimin e karburantit duke shmangur me rigorozitet rrjedhjen e tyre ne sheshet e ambjenteve te aktivitetit.

- **Emetimet ne ajer**

Nga proceset e magazinimit dhe furnizimit me nafte dhe nenproduktet e saj, kemi gjenerimit te gazrave dhe avujve te demshem te cilat jane tipike per procese te tilla pune per ruajtjen e tyre. Gjithashtu te pranishme ne терминаlet e shkarkimit jane edhe aromat e gazit (squfur) te cilat jane te pashmangshme edhe pse shoqeria ka marre masat e nevojshme per reduktimin ne maksimum te ketyre shkarkimeve. Ne rastin e rrjedhjeve aksidentale subjekti ka mar masa per menaxhimin e rrjedhjeve nepermjet teknikave me te mira per shmangjen maksimale te ndotjes se ujrave nentokesore.

- **Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kemi ndikime ne toke pasi sheshi i ambjenteve te magazinimit dhe tregtimit me nafte dhe nenproduktet e saj, eshte i shtruar me pllaka betoni duke shmangur depertimin e karburantit ne rast aksidentesh ne shtresat e tokes. Per sa i perket mbetjeve qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punetoreve, grumbullimi i tyre dhe diferencimi behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e aktivitetit.

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe gjenerohen ne mjedisin ne fjale, vijne kryesisht nga procesi i shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj ne ambientet e aktivitetit. Keto zhurma jane momentale deri ne perfundim te magazinimit dhe furnizimit te makinave me karburant.

Vleresimet per zhvillimin e aktiviteve te tilla, rezultojne se gjenerimi i zhurmave eshte ne nivele te ulta dhe qe nuk ndikojne ne mjedisin e zones perreth dhe punonjesit. Objekti ne fjale ndodhet ne periferi te qytetit te Vlores ne afersi te fshatit Zvernec.

- **Ndikimet ne flore/faun**

Aktiviteti zhvillohet brenda konturit te siperfaqes se aktivitetit duke mos ndikuar aspak ne floren dhe faunen e zones. Perkundrazi ne konturet rrethuese te prones eshte mbjelle breze me bimesi duke mbrojtur zonen perreth nga pluhurat dhe aromat e pa kendeshme qe gjenerohen nga procesi i magazinimit dhe furnizimit me nafte dhe nenproduktet e saj.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjeve qe gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetjet nga aktiviteti jetesor i punetoreve, grumbullimi i tyre dhe diferencimi behet nepermjet sistemit te koshave te vendosur ne ambientet e objektit.



## MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

### Masat e propozuara per funksionimin eficient dhe te sigurt te punes ne aktivitetin e tregtimit te karburantit:

- ✓ Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe bime dekorative autoktone ne kushte artificiale per te rritur koeficientin e gjelberimit.
- ✓ Te shmanget ne maksimum perdorimi i mjeteve te transportit kur nuk eshte e nevojshme dhe te reduktohen zhurmat ne oret e vona.
- ✓ Te kryhet rrethimi i objektit dhe linjes se depozitimit te karburanteve dhe te vendosen tabela paralajmeruese per rreziqet per kalimtare dhe punonjesit.
- ✓ Te reduktohet qarkullimi ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar ne zone.
- ✓ Te mos perdoren borite e mjeteve ne qendrat e banuara dhe qarkullimi te kryhet me shpejtesi te ulet.
- ✓ Te vendosen kontenier per mbajtjen paster te ambjenteve nga mbetjet urbane per numrin e punonjesve.
- ✓ Mbetjet e rrezikshme me permbajtje hidrokarbure te rikuperohen dhe asgjeshohen nga subjekte te licencuara.
- ✓ Investitori te respektojte detyrimet e vendosura ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga AKM.
- ✓ Subjekti te respektojte te gjitha masat/normat/planet/shkarkimet qe do te deklarohen ne formular-Kerkese per Leje Mjedisore Tipi B.
- ✓ Subjekti te jete ne dijeni dhe te azhurnohet per kuadrin ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- ✓ Subjekti te respektojte dhe zbatoje kushtet teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri dhe te krijojte infrastrukturen e nevojshme per zjarrefikset.
- ✓ Te kryhet monitorimi i indikatorëve te mjedisit sipas ligjeve ne fuqi.
- ✓ Eshte detyre e zbatuesve te projektit te integrojne elementet e domosdoshem te propozuar per parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative ne mjedis, shendet dhe aspektin social.
- ✓ Eshte detyre e Njesise Vendore gjithashtu te zbatoje rigorozisht detyrimet e percaktuara per te garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit.
- ✓ Eshte detyre e te gjith kontraktoreve e nenkontraktoreve te ndryshem si gjate fazes se depozitimit te karburanteve te zbatojne me kujdes detyrimet perkatese te parashikuara me siper.

**Masa lehtesuese te kerkuara**

- ✓ Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike, kjo do te coj ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike nga perdorimi i makinerive/impianti me eficence.
- ✓ Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe paisja e vend-parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- ✓ Subjekti te kryej aktivitetin per shperndarjen dhe magazinimin e karburantit vetem brenda kordinatave te siperfaqes se tokes qe disponon ne zoterim.
- ✓ Do te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne menyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari te mundshme teknike te mjeteve.
- ✓ Do te instalohet sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato do te kene) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor.
- ✓ Linja e impiantit te instaluar ne objekt, do te koluaudohet ne menyre periodike nga teknike te specializuar dhe çertifikuar per te tilla procese.
- ✓ Veglat/Pajisjet/Makinerite e punes qe sherbejne per procese te ndryshme do te zevendesohen me te reja, sipas jetegjatesise se tyre dhe eficences qe kane ne kryerjen e operacioneve depozitimit te karburanteve.
- ✓ Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet ne zonen e shfrytezuara do te lyhet periodikisht me boje higjenike dhe antikorrozive, me qellim plotesimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- ✓ Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te aballazheve, letra/kartona, si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit dhe klientat, ku keto mbetje do te transportohen rregullisht ne vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selective sipas rrymave specifike te mbetjeve.
- ✓ Do te behet pastrimi periodik i rrjetit te drenazhimit te ujrave te pastrimit dhe ujit te shiut ne kete objekt ose e mjedisit perreth drejt mjedisese te gjeberuara, nje mundesi e mire dhe per vaditje dhe shmangie te derdhjes se tyre ne mjedis si dhe shmangie te perdorimit te ujit te pijshem per vaditje. Mjedis i gjelberuar perreth do te jete nen kujdesjen e personelit qe do te punesohet vetem per punimet agro-mjedisore te nevojshme
- ✓ Rrjeti elektrik eshte tokezuara per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike.
- ✓ Zona ku do te realizohen operacioni i magazinimit dhe furnizimit me karburant eshte e rrethuar, me qellim per te shmangur hyrjet e pa autorizuar te individeve dhe faunes se zones perreth.
- ✓ Jane ndermarre te gjitha masat e domosdoshme te mbrojtjes kundra zjarrit. Per te mbrojtur kunder zjarrit te mundshem qe mund te bjere do te ruhen largesite mbrojtese ndaj zjarrit te objektit dhe linjes se depozitimit te karburanteve.
- ✓ Aktiviteti i disponon infrastrukturen e nevojshme, me distancat e percaktuara per rruge kalim te punonjesve, automjeteve, zjarrefiksive, etj.



## PIKE SHITJE KARBURANTI

---

- ✓ Do te behet trajnimi periodik i punonjesve mbi kushtet e sigurimit teknik gjate operimit te punes, si dhe te kualifikohen stafi pergjegjes per operimin e punes ne objektin e magazinimit dhe furnizimit me karburant.